



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / جمهورية كوسوفو			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	5A-02	Nr i Prot. Broj Prot. Prot.No	4558-2/24
Nr i Faqëve Br. Stranica No.Pages	- 03 -	Data: Datum: Date	03.02.25
PRISHTINË / A			No.1

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	21.01.2025
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/4558/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Alpeg Group" Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/4558/454/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Alpeg Group" Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë - për stacionin e karburanteve në Vranidoll, Prishtinë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

## V E N D I M

**Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë “Alpeg Group” Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburanteve në ngastrën kadastrale me Nr. P-71914012-01148-1 zona kadastrale Vranidoll, Prishtinë.**

## A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë “Alpeg Group” Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë, e cila ka aplikuar për stacionin e karburanteve në Vranidoll, Prishtinë, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/nmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)



- Mungon Pëlqimi i Komunës së Prishtinës;
- Licenca e Gjeodetit;
- Licenca e hartuesit të raportit të VNM-së;
- Vlera Investuese e Projektit në formë tabelare;
- Situacioni gjeodezik të përgatitet vetëm për dy aparatet e para (afër objektit) toçitjet e derivateve kurse toçitjet tjerat të eliminohen, situacioni të përmbaj largësinë në mes rrugë dhe aparatit (toçitjes);

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Alpeg Group" Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë, me datën 18.11.2024 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara nuk janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Bazuar në të lartcekuaat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Alpeg Group" Sh.p.k Vranidoll, Prishtinë ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburanteve në ngastrën kadastrale me Nr. P-71914012-01148-1 zona kadastrale Vranidoll, Prishtinë.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/4558/1- ZSP/ /25 datë: 21.01.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Prishtinës
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të



Faqe 3 nga 3